



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT  
KORÇË  
VENDIM

Nr 70 Datë 15.10.2007

PËR  
MIRATIM FONDI PREJ 754.000 LEKE PËR KONKURSIN  
NDËRKOMBËTAR TË ARTEVE FIGURATIVE "VANGJUSH MIO"

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Sektori i Kulturës dhe Drejtoria e Financës për "PËR MIRATIM FONDI PREJ 754.000 LEKE PËR KONKURSIN NDËRKOMBËTAR TË ARTEVE FIGURATIVE "VANGJUSH MIO", bazuar ligjin nr. 8652 dt 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 32, pika "dh", ligjin nr 8379 dt. 09.09.1998 "Për buxhetin lokal", Ligji nr 9645 dt. 27.11.2006 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2007", Udhëzimin nr 2 dt 17.01.2007 të M.F. "Për zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2007", Udhëzimin nr 353 dt.19.03.2007 të Ministrise se Brendshme "Për zbatimin e Buxhetit të Qeverisjes Vendore për vitin 2007", V.K.M. nr. 228 dt 13.04.2001 «Për dietat e nepunësve që dërgohen me shërbim jashtë vendbanimit të tyre», V.K.M. nr.258 dt. 03.06.1999 «Për një ndryshim në V.K.M. nr 243 dt. 15.05.1995 «Për shpenzime, pritje, përcjellje që ju bëhen delegacioneve të huaja » si dhe V.K.B. nr 2 dt.02.02.2007 «Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2007», mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1.Të miratojë fondin prej 754.000 lekë për Konkursin ndërkombetar të arteve Figurative « Vangjush Mio ».

2. Ky fond do të përballohet nga fondi rezervë i të ardhurave të Bashkisë Korçë me këtë strukturë buxhetore :

*Pakësohet*                    00   04980   5            *Art 6091100 - 754 000 lekë*

*Shtohet*                        00   08250   5            *Art 6020000 + 754 000 lekë*

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Sektori i Kulturës ne Bashki dhe Qendra Ekonomike e Kulturës "V.Mio".

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

***Kryetare e Këshillit***

*Raimonda NASE*  
**Raimonda NASE**

Dixhitalizuar nga Qendra e QIP  
www.infocip.org